



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 shkurt 2020
Nr. ref.:RK 1510/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI54/19

Parashtrues

Pashke Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
PAKR. nr. 329/18, të 23 gushtit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Pashke Krasniqi, (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) nga fshati Meqë, Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Teuta Gashi, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 329/18, të 23 gushtit 2018, si dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 21/19, të 27 nëntorit 2018.
3. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 329/18, i 23 gushtit 2018, iu dorëzua parashtrueses së kërkesës më 28 gusht 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 prill 2019, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 10 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës emëroi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 19 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
9. Më 11 nëntor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Gjakovë që të bashkëngjisë kopjen e vërtetimit se kur i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 329/18, i 23 gushtit 2018 parashtrueses së kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
10. Më 20 nëntor 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë ia bashkëngjiti Gjykatës vërtetimin për dorëzim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 329/18, te parashtruesja e kërkesës, me datë të dorëzimit të 28 gushtit 2018.
11. Më 15 janar 2020, Kolegji shqyrtues, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 23 gusht 2016, në të shtënat që ndodhën në qendër të Gjakovës, me armë zjarri u vra i biri i parashtrueses së kërkesës dhe dy persona të tjerë.
13. Më 31 janar 2018, lidhur me incidentin e lartpërmendur, Prokuroria Themelore në Gjakovë ngriti aktakuzën PP/I. nr. 138/2016 kundër të dyshuarve, me dyshimin e bazuar se ata kishin kryer veprën penale të vrasjes në bashkëkryerje dhe veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.
14. Më 30 prill 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktgjykimin PKR. nr. 6/2018, shpalli Q.Sh.-në dhe V.G.-në fajtorë për kryerjen e veprës penale të vrasjes në bashkëkryerje dhe veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe rrjedhimisht i shqiptoi Q.Sh.-së dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 vjet e 6 muaj, ndërsa V.G.-së i shqiptoi dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 11 vjet e 6 muaj.
15. Më 13 qershor 2018, parashtruesja e kërkesës paraqiti në Gjykatën e Apelit ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë për shkak të *“shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkelje të Kodit Penal dhe vendimit në lidhje me sanksionin penal”*.
16. Më 23 gusht 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PAKR. nr. 329/2018, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
17. Më 5 nëntor 2018, parashtruesja e kërkesës i paraqiti Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit propozimin për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit (PKR. nr. 6/2018) të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Aktgjykimit (PAKR. nr. 329/2018) të Gjykatës së Apelit.
18. Më 3 dhjetor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit i dorëzoi parashtrueses së kërkesës njoftimin (KMLP. I. nr. 21/19) e 27.11.2018 në të cilin, *konstaton se nuk ka gjetur bazë ligjore për iniciimin e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.*

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

19. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
20. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj konsideron se, *“Vendimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit i datës 27.11.2018, si vendim i fundit për sa i përket mjetit të fundit efektiv që parashtruesja e kërkesës ka pasur në dispozicion, është pranuar nga përfaqësuesja e të dëmtuarës – parashtrueses, av. T. G., më 03.12.2018, që do të thotë se afati i fundit, si afat prej katër muajve, për*

parashtrimin e kërkesës individuale në Gjykatën Kushtetuese do të ishte më 03.04.2019”.

21. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm pasi që gjykatat e rregullta nuk kishin arsyetuar në mënyrë adekuate pse vepra e kryer penale ishte kualifikuar si “*urasje*” e jo si “*urasje e rëndë*”.
22. Parashtruesja më tej pretendon se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm pasi që gjykatat e rregullta nuk kishin arsyetuar në mënyrë adekuate marrëdhënien midis rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjatë përcaktimit të dënimit të shqiptuar.
23. Parashtruesja gjithashtu pretendon se është shkelur parimi i barazisë para gjykatës sepse, “*kishte kërkuar që gjykata të mos ia fal besimin raportit të ekspertëve të psikiatrisë forenzike, të cilët kishin deklaruar se që të dy të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale kanë qenë në gjendje të përgjegjesisë esencialisht të zvogëluar, duke kërkuar kësisoj ekspertizë të re psikiatrike. Megjithatë, Gjykata çuditërisht në të njëjtën seancë nuk vendosi fare për një kërkesë të tillë, duke e anashkaluar në tërësi kërkesën për caktimin e ekspertëve të rinj*”.
24. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të aprovojë kërkesën dhe të konstatojë, “*se shkelja e neneve të mësipërme nga ana e autoriteteve publike përkatësisht nga ana e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë si dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të konstatojë se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka bërë shkelje të të drejtave kushtetuese me rastin e refuzimit të iniciativës - propozimit për të parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë*”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të cilat janë të përcaktuara më tej në Ligj. Në këtë

kuptim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

28. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë.
29. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

30. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, [...].”

31. Për të qenë në gjendje të verifikojë nëse kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor, Gjykata merr parasysh “vendimin e fundit” me të cilin është vendosur në lidhje me kërkesën e parashtrueses, datën kur parashtruesja ka pranuar vendimin në fjalë dhe datën e parashtrimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Ky konstatim është vërtetuar edhe në praktikën gjyqësore të

Gjykatës në rastet: KI154/14, Parashtruesit e kërkesës: *Bujar Nrecaj dhe Haxhi Nrecaj*, Aktvendimi për Papranueshmëri i 30 qershorit 2016, paragrafi 35; dhe KI201/13, Parashtruese e kërkesës: *Sofa Gjonbalaj*, Aktvendimi për Papranueshmëri i 2 prillit 2014, paragrafi 32.

32. Sa i përket “*vendimit të fundit*”, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 329/18, i 23 gushtit 2018, është vendimi i fundit në lidhje me kërkesën e parashtrueses.
33. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se aktgjykimi në fjalë është shpallur më 23 gusht 2018, ndërsa parashtruesja e kërkesës e ka pranuar këtë aktgjykim më 28 gusht 2018. Në këtë kuptim, si *dies a quo* e afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, merret data e pranimit të aktgjykimit nga parashtruesja e kërkesës, respektivisht 28 gushti 2018. Afati fillon të rrjedhë nga momenti kur vendimi bëhet i formës së prerë si rezultat i shterimit të mjeteve juridike adekuate dhe efikase për të siguruar korigjimin e çështjes e cila është objekt i ankesës (shih: *mutatis mutandis*, *Norkin kundër Ruisë*, Kërkesa 21056/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih, gjithashtu, *Moya Alvarez kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).
34. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës se “*Vendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit i datës 27.11.2018, si vendim i fundit për sa i përket mjetit të fundit efektiv që parashtruesja e kërkesës ka pasur në dispozicion, është pranuar nga përfaqësuesja e të dëmtuarës – parashtrueses, av. T. G., më 03.12.2018, që do të thotë se afati i fundit, si afat prej katër muajve, për parashtrimin e kërkesës individuale në Gjykatën Kushtetuese do të ishte 03.04.2019*”, Gjykata vëren se është fakt që parashtruesja e kërkesës ka pranuar njoftimin e fundit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në datën e cekur, por sipas këtij njoftimi Kryeprokurori i Shtetit nuk ka iniciuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me çështjen e parashtrueses, me arsyetimin se: “*nuk ka gjetur bazë ligjore për iniciimin e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë*”.
35. Prandaj, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar te Prokurori i Shtetit është mjet juridik që nuk është në dispozicion të drejtpërdrejtë të parashtrueses së kërkesës, por varet nga “*ndërmjetësi*”, ndërsa në rastin konkret “*ndërmjetësi*” është Prokurori i Shtetit, dhe si e tillë, nuk shqyrtohet nga ana e Gjykatës (shih *Tanase kundër Moldavisë*, [VV], paragrafi 122).
36. Si i tillë, njoftimi i Kryeprokurorit të Shtetit nuk konsiderohet të jetë “*vendim i fundit*” në lidhje me çështjen e parashtrueses së kërkesës, sepse “*vendim i fundit*”, sipas nenit 49 të Ligjit, do të ishte përndryshe vendimi i fundit me të cilin është refuzuar ankesa e parashtrueses së kërkesës, që në këtë rast është Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit (shih, *mutatis mutandis*, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendimi i 14 marsit 2002).
37. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se “*vendim i fundit*” në lidhje me çështjen e parashtrueses së kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe afati fillon të rrjedhë nga data e pranimit të këtij aktgjykimi (shih, *mutatis mutandis*, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 38587/97,

GJEDNJ, Vendimi i 29 janarit 2002). Rrjedhimisht, vihet re se parashtuesja e kërkesës e ka pranuar këtë aktgjykim më 28 gusht 2018, ndërsa kërkesën e ka parashtuar më 3 prill 2019 në Gjykatën Kushtetuese.

38. Bazuar në atë si më sipër, rezulton se kërkesa nuk është parashtuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
39. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata konkludon që kërkesa e parashtueses nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri sepse nuk është e afatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 janar 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20, paragrafin 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Arta Rama-Hajrizi